

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

28.02.2023  
Ora 12:41

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 05 dhe 08 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Dhurata Gjoka, drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Durrësit””.*

**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

**Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaç, Znj. I. Osmanaj, Znj. K. Bici,  
Znj. A. Agolli

**Të tjerë:** Z. V. Manushi, Përfaqësuesi i Bashkisë së Durrësit.

**KRIIK**

**Z. K. Bele:** Përhëndetje! Deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtimin në themel të kërkesës nr. 5 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me objekt kërkesën për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Dhurata Gjoka, drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Durrësit. Sipas shortit të hedhur relator i kësaj çështje jam unë, Koli Bele. KAS-i është i mbledhur në kuorum, të pesë anëtarët janë prezent, gjithashtu, e pranishme është edhe administrata. Në seancën e ditës së djeshme është kaluar, është bërë shqyrtimi paraprak dhe është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim sot. Pyesim dhe verifikojmë nëse kemi palë të tjera prezente për Bashkinë e Durrësit, apo për personin, zonjën Dhurata Gjoka?

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. V. Manushi:** Për Bashkinë e Durrësit, unë jam Vangjel Manushi, shefi i sektorit Juridik.

**Z. K. Bele:** Faleminderit! A ka ndonjë pyetje, apo kërkesë paraprake lidhur me anëtarët e KAS-it? Jo. Shkurtimisht sekretari i Përgjithshëm do të na thotë dy fjalë ku jemi me procesin. Gjithashtu, ju informojmë që, meqenëse jemi në fillim të procesit, bashkë me këtë kërkesë do të vlerësohet, pra, është bërë bashkimi i kërkesës me nr. 5 me atë nr. 8 pasi në të dyja rastet kemi zonjën Dhurata Gjoka, drejtore e Burimeve Njerëzore. Këto kërkesa, duke qenë se janë të lidhura në objekt, do të dëgjohehen në këtë shqyrtim administrativ së bashku. Po, Ylli.

**Z.Y. Merkaç:** Faleminderit! Gjatë periudhës së monitorimit, datë 20 janar deri 23 janar të vitit 2023, Bashkia e Durrësit ka raportuar në ndërfaqen e raportimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dy veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar nga neni 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor dhe konkretisht aktiviteti për mbjellje pemësh dhe shtimi i koshave në qytet dhe aktiviteti tjetër është vendosja e ndriçimit të ri në rrugën “Hazis Shkupi”. Gjatë hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konstatuar, ka vlerësuar se këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia e Durrësit ka shkelur detyrimin ligjor duke mos raportuar brenda afatit të përcaktuar në ligj. Në këto rrethana Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka propozuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë në masën 10 mijë lekë për shkelje të dispozitave të nenit 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor ndaj personit përgjegjës për raportimin, zonjës Dhurata Gjoka, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Durrësit. Komisioneri i ka propozuar KAS-it për vendosjen e masës administrative dhe jemi në shqyrtim të saj. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. K. Bele:** Dhe, për kërkesën nr.8, se është një lapsus nga ana ime, pra janë kërkesat nr. 5 dhe nr. 8.

**Z. Y. Merkaç:** Kërkesa ankimore nr. 5 ka qenë për periudhën 20 janar -23 janar ndërsa periudha e monitorimit për kërkesën ankimore nr. 8 ka qenë 24 janar – 2 shkurt të vitit 2023, ku Bashkia e Durrësit ka raportuar në ndërfaqen e raportimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 19 veprimtari përtej afatit ligjor, të përcaktuar sipas nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konstatuar se 6 nga këto veprimtari janë veprimtari publike dhe Bashkia e Durrësit ka shkelur detyrimin për t'i raportuar këto brenda afatit, i ka raportuar jashtë afatit të përcaktuar në ligj. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për 6 nga këto veprimtari, i ka propozuar Komisionit të Ankimit dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë në masën 10 mijë lekë për personin përgjegjës për raportimet, Dhurata Gjoka drejtoresh e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë së Durrësit. Aktualisht veprimtari, të cilat janë konsideruar veprimtari publike jashtë afatit të raportimit, ka qenë: aktiviteti i inspektim-kontrollit raportuar me datën 24.01.2023 dhe data e zhvillimit të këtij aktiviteti ka qenë data 25.01.2023; aktiviteti tjetër ka qenë inspektim- kontroll, raportuar më datën 25.01.2023, dhe data e zhvillimit ka qenë data 26.01.2023; aktivitetet inspektim-kontrolli i raportuar me datën 25.01.2023 dhe zhvillimi ka qenë më datën 26 01.2023, aktiviteti tjetër është aktivitetet inspektim-kontrolli, i raportuar me datën 25.01.2023 dhe është zhvilluar më datën 26.01.2023. Gjithashtu, kemi dy aktivitete të tjera të raportuara më datën 28.01.2023 dhe aktiviteti është zhvilluar më datë 31.01.2023; dhe aktiviteti i fundit, aktiviteti nr. 6, inspektim-kontrolli, i raportuar më 31.01.2023, dhe i zhvilluar më datën

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

02.02.2023. Për raportimet e tjera Komisioni ka vlerësuar që nuk janë veprimtari publike dhe nuk i ka konsideruar të tilla.

**Z. K. Bele:** Unë kam dy pyetje për ju, por, pasi të dëgjojmë zotërinë, që ndoshta do të na shpjegojë më shumë, pastaj do të vazhdojmë.

**Z. V. Manushi:** Lidhur me dy veprimtaritë e para, që ishin te vendimi nr. 5, kam diçka për të sqaruar. Këto dy veprimtari janë në kuadër të procesit të rindërtimit. Janë në zbatim të nenin 23 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, “Funkcionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”. Këto kanë qenë inspektime në terren të inspektimeve të bashkisë në kuadër të transparencës së përdorimit të fondeve publike, në kuadër të investimit të miratuar të buxhetin e saj në zbatim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 150, datë 22.12.2022, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm të Bashkisë së Durrësit dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Durrësit për vitin 2023”. Sqarojmë se në këtë inspektim nuk ka pasur prezencë të medieve, nuk ka pasur publik, nuk ka qenë kryetarja e bashkisë prezent. Këto mund t’i verifikoni edhe në faqen zyrtare. Nuk ka pasur premtime elektorale, dhe ne e konsiderojmë, që nuk quhet veprimtari publike, që duhej raportuar. Gjithsesi personi përgjegjës ka raportuar tej afateve duke pas frikën e sanksionit. Për të dy veprimtaritë e para, ato po të shihni fotot që janë në publikuar në faqen e Facebook-ut, është thjeshtë një rrugë pa njerëz vetëm me ndriçimin e rrugës, led, dhe asnjë person afër. Njëkohësisht edhe ai i mbjelljes së pemëve janë dy punëtorë duke mbjellë një pemë, nuk ka kryetar bashkie, nuk ka medie nuk ka publik, pra është thjeshtë një transparencë e punës së institucionit. Këto janë të verifikueshme në faqen zyrtare. Ndërsa për pikat e tjera, nëse doni të vazhdoj, po vazhdoj.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. K. Bele:** Pra, ju...

**Z. V. Manushi:** Për këto të dyja, unë pretendoj se nuk duhet të konsiderohen aktivitete publike që i detyron ligji për t'u raportuar.

**Z. K. Bele:** Po këto aktivitete e tjera të kërkesës nr. 10?


**Z. K. Bele:** Për aktivitetet e tjera, do të grupohen në dy kategori. Njëra kategori është që i qëndrojmë po të njëjtit pretendim, që thamë për pikat 1 dhe 2 të kësaj. Janë disa aktivitete që nuk janë zhvilluar, gjithsesi është raportuar, por nuk është zhvilluar aktiviteti, por njëkohësisht janë edhe aktivitete që nuk janë pasqyruar. Pra, duke qenë se kemi qenë tej afateve, aktiviteti është zhvilluar, por nuk është pasqyruar në media dhe janë ....

**Z. I. Rusmali:** Këto nuk janë fare në kërkesën e Komisionierit, apo jo? Këto tri aktivitete.

**Z. V. Manushi:** Janë aktivitete, të cilat nuk janë pasqyruar. Inspektimi në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike, nuk është pasqyruar në media fare. Është zhvilluar...

**Z. K. Bele:** Pra, është i njëjti argument si herën e parë, thoni ju, që nuk kanë pasur media për karakterin publik.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. V. Manushi:** Në një rast është kjo, që kryetari i bashkisë është në zbatim të funksioneve, të detyrave të veta të ngarkuara nga ligji i transparencës me publikun, për fondet publike.

**Z. K. Bele:** Cili rast?

**Z. V. Manushi:** Të gjitha, por një pjesë e tyre nuk është pasqyruar fare, nuk ka as foto.

**Z. K. Bele:** Po si e mori vesh Komisioneri Publik?

**Z. V. Manushi:** Vetëm nga njoftimi, raportimi që ka bërë në faqe personi përgjegjës.


**Z. K. Bele:** Po, më fal, në qoftë se e kuptova drejt, personi përgjegjës, që të jetë në rregull, ka raportuar çdo lloj aktiviteti të bashkisë?

**Z. V. Manushi:** Po, edhe ato të cilat Komisioneri i ka kthyer dhe nuk i ka konsideruar shkelje.

**Z. K. Bele:** Pra, këto tri aktivitete, që ju i përmendët, a mund t'i identifikoni cilat janë?

**Z. V. Manushi:** Po. Nuk është pasqyruar në media aktiviteti inspektim kontroll në kantierin e punimeve të objekteve të ndërtimit të S4-s, të raportuar në datën 25, në mos gabohem. Nuk është pasqyruar në media inspektimi në shkollën "Eftali Koçi".

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. I. Rusmali:** Kjo është ajo shkolla arkeologjike?

**Z. V. Manushi:** Jo, është një shkollë që është diku te rruga, nga Muzeu i Dëshmorëve deri te Drejtoria e Policisë në krah të majtë. Është zhvilluar aktivitet, por nuk është bërë pasqyrimi në media.

**Z. K. Bele:** Në qoftë se ke dijeni, çfarë lloji aktiviteti, çfarë bën kryetari konkretisht, ta kuptojmë edhe ne.

**Z. V. Manushi:** Nuk ka bërë aktivitet, ka shkuar të verifikojë, të kontrollojë punimet e ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*


2 nuk janë pasqyruar fare, ndërsa të tjerat nuk janë aktivitete, janë thjesht në funksion të detyrës së kryetarit të bashkisë për të inspektuar. Po t'i shikoni një nga një të gjitha ato, t'i lexoni, janë të qarta, janë thjesht inspektime punimesh pa publik, pa media.

**Z. I. Rusmali:** A mund ta pyes edhe një herë? Të lutem, këto 2 aktivitete që na identifikove, që nuk kanë pasur pasqyrim në media, janë aktivitete publike, sipas atij përkufizimi që u dhatë ju dy të parave?

**Z. V. Manushi:** Unë i konsideroj se jo, nuk janë aktivitete, gjithsesi ato nuk janë publikuar, duke pasur frikë...

**Z. I. Rusmali:** Për dy të parat ju kishit referenca nga Facebook-u, fotografitë që tregonin që s'kishte pjesëmarrje nga publiku, për këto dy të tjerat thoni që nuk janë

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

aktivitete publike, po për shkak se nuk janë pasqyruar gjëkund, unë nuk jua sjell dot provat që nuk ka pasur njerëz atje. Kështu, ky është perceptimi?

**Z. V. Manushi:** Jo, nuk i kam parë në faqet publike të Bashkisë së Durrësit.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, po si na e konfirmon që nuk ishin publike këto dy të tjerat?

**Z. V. Manushi:** Sepse janë në funksion të detyrave të kryetarit të bashkisë; ka bërë thjesht inspektim në terren të ndërtimeve, nuk ka bërë takim.

**Z. I. Rusmali:** Inspektim në terren, ka shkuar në kantier dhe nuk ka pasur publik atje ku ka shkuar në kantier dhe nuk ka komunikuar me publikun. Na e provon dot këtë gjë, që s'ka pasur publik dhe nuk kanë komunikuar, sepse ne jemi përpara situatës që kemi drejtoreshën e Burimeve Njerëzore, që i ka konsideruar veprimtari publike dhe drejtorin juridik, që i thotë se nuk janë veprimtari publike. Ne duhet të zgjedhim midis 2 pozicioneve: tuajin dhe të koleges suaj. Që të zgjedhim na duhet një provë që të besojmë njëri palë apo palën tjetër. Kemi mundësi ta ndajmë këtë?

**Z. V. Manushi:** Jo, unë nuk mund ta ndaj dot, sepse duhet t'u kërkoj kolegëve të na e tregojnë në faqen e Facebook-ut, pastaj Facebook-u, në dijeninë time, nuk është media.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, na bën dot analizën e aktiviteteve të tjera? Katër ke bërë deri tani.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. V. Manushi:** Unë t'i ndava në dy kategori ato që ishin tek e dyta, që thashë që janë aktivitete, edhe pse nuk janë aktivitete publike dhe nuk janë pasqyruar në media, janë thjesht ushtrimi i funksioneve dhe pjesa tjetër, që është ushtrimi i funksioneve të kryetarit të bashkisë dhe pa prezencën e publikut dhe të mediave, tek të dyja rastet.

**Z. K. Bele:** Ylli, ju i keni vlerësuar këto rast pas rasti? Pra, çfarë qëndrimi keni për këto që pretendon ose sqaron përfaqësuesi i bashkisë.

**Z. Y. Merkaj:** Ne kemi vlerësuar që duke marrë bazë raportimin që ka bërë nëpunësi përgjegjës për raportimet dhe në disa nga këto raportime ka shkruar që është me pjesëmarrjen e mediave, ne e kemi konsideruar si veprimtari publike. Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike.

**Z. K. Bele:** Në çfarë date?


**Z. Y. Merkaj:** Datë 25.01.2023, ka raportuar që është e hapur për publikun.

**Z. K. Bele:** Ju mendoni që e hapur për publikun, pa pjesëmarrjen e medias, e bën aktivitetin publik?

**Z. Y. Merkaj:** Është një nga kriteret. Po kështu edhe tek infrastruktura arsimore, thotë inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës arsimore.

**Z. K. Bele:** Kurse ligji thotë: .... nga publiku dhe të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe që kanë në agjendë

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

informimin”. Pra, fakti që është i hapur për publikun e kënaq, se t’i kërkon të dyja ligji dhe të ketë agjendë informimi. Dakord. Desha qëndrimin tuaj.

**Z. V. Manushi:** Edhe një shtesë tjetër nëse ka mundësi. Komisioneri Qendror për Zgjedhjet në një rast analog të vitit të kaluar për Bashkinë Durrës këto aktivitete nuk i ka konsideruar aktivitete publike, por i ka konsideruar si ushtrim i funksioneve të kryetarit të bashkisë. Në mos gabohem, numrin e vendimit nuk e mbaj mend, por është vendimi i periudhës së majit të vitit 2022 kur kanë qenë zgjedhjet e parakohshme për kryetar bashkie.

**Z. K. Bele:** Në ushtrim të aktivitetit mund të kryejë veprimtari me karakter publik ose mund kryejë veprimtari që janë me karakter të përditshëm, siç mund të jenë takime apo çdo lloj aktiviteti tjetër që ai bën brenda apo jashtë zyrave. Ajo që na duhet të ndajmë në këtë diskutim dhe në këtë hetim administrativ është nëse janë aktivitete publike ose jo dhe pastaj do të shikojmë atë që kërkon ligji në raport me detyrimin për raportim. Pra, këtu është thembra e Akilit dhe thelbi i diskutimi, pasi ju keni zgjedhur t’i raportoni *en bllok*, pra shabllon. Çfarë ndodh në bashki dhe jo vetëm ju, por edhe bashkitë e tjera duke dashur që të jenë në rregull, kanë marrë çfarë aktiviteti ka bashkia dhe e kanë nisur të gjithën. Në fakt, kjo na ka konfuzuar pak situatën. Kishe pyetje?

**Z. E. Lako:** Jo, unë dua një sqarim nga përfaqësuesi i Bashkisë Durrës. Përderisa Bashkia Durrës i ka raportuar këto aktivitetet, do të thotë që i ka futur te grupi i aktiviteteve që janë me karakter publik. Është mendimi juaj që këto aktivitete nuk janë apo është mendimi i bashkisë. Ju mendoni që nuk janë, se përderisa bashkia i ka sjellë me shkresë, i ka futur tek aktivitetet me karakter publik dhe KQZ-ja e ka

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*


nisur këtë hetim në bazë të raportimit që ju keni bërë, nuk është se ka iniciuar ndonjë hetim nga ana e vet dhe ka konstatuar që janë apo jo këto aktivitete, domethënë ky raportim ka filluar në bazë të raportimit që ju keni bërë. Është bërë gabim raportimi, apo është mendimi juaj që këto nuk janë me karakter publik?

**Z. V. Manushi:** Unë i konsideroj që nuk janë aktivitete publike. Kjo nisët edhe nga aktet ligjore që jam konsultuar. Kështu që, ato janë raportuar, siç e tha edhe kryetari, këto janë raportuar nga të gjitha bashkitë dhe e njëjta procedurë është bërë nga të gjithë edhe nga frika e mosmarrjes së gjobës. Bashkia Durrës ka raportuar edhe në mbledhjen e këshillit bashkiak. Në mbledhjen e këshillit bashkiak nuk raportohet, sepse është transparencë e institucionit lidhur me ato praktika që trajton këshilli bashkiak lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij. Jo, nuk e kërkoj te ju, unë thashë që kjo nuk ka ndodhur vetëm me ne, ka ndodhur me të gjitha bashkitë. Ky është një gabim që unë e konsideroj më shumë nga frika sesa ...

**Z. I. Rusmali:** Këto sqarime deri tani na shërbejnë për të kuptuar diçka nga konteksti i gjësë, por kërkesa që na ka ardhur ne është kërkesë për shkelje specifike dhe shkelja specifike është mosrespektimi i afatit minimal ligjor prej 5 ditësh në kryerjen e raportimeve. Lidhur me këtë gjë specifike, fakti që janë bërë raportime në një afat më të vogël sesa 5 ditë, keni ndonjë gjë për të thënë ju?

**Z. V. Manushi:** Një nga problemet që ka pasur bashkia ka qenë edhe mosfunksionimi i faqes në periudhën e asaj kohe, ka pasur probleme me internetin, probleme në aksesimin në faqe. Këto i kemi paraqitur edhe te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve herën tjetër, megjithatë unë vazhdoj të insistoj te kjo që ky aktivitet...

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. I. Rusmali:** Me “herës tjetër” çfarë i referohesh?

**Z.V. Manushi:** Kur janë paraqitur te Komisioneri...

**Z. I. Rusmali:** Kur e ka marrë në shqyrtim Komisioneri këtë çështje, jo më përpara.

**Z. V. Manushi:** Jo.

**Z. I. Rusmali:** Aktet tona parashikojnë që kur nuk funksionon faqja, parashikojnë mënyrë alternative komunikimi. Ju e keni shfrytëzuar këtë mënyrën alternative të komunikimit?


**Z. V. Manushi:** Në dijeninë time, jo.

**Z. K. Bele:** Kam një pyetje për administratën. Ylli, në qoftë se ke informacion, konsiderimi i këtyre aktiviteteve kur vetëdeklaruesi i konsideron që janë pa pjesëmarrjen e publikut dhe pa publikun, për çfarë arsye konsiderohen si publike nga Komisioneri, për shkak të vetë faktit raportimit apo për shkak të faktit se këto aktivitetet janë publikuar në faqen e *facebook*-ut të kryetares së bashkisë apo Bashkisë Durrës?

**Z. Y. Merkaj:** Jo vetëm për pjesëmarrjen e publikut, por edhe për agjendën që ka pasur aktiviteti, mund të ketë qenë agjendë informuese. Dhe kjo është një nga arsyet për tematikën që ka pasur aktiviteti.

**Z. K. Bele:** Si përkufizohet agjenda informuese kur nuk ke pjesëmarrje të publikut?

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Janë këto rrjetet sociale, facebook...

**Z. K. Bele:** Ngelemi te fakti i pasqyrimin në rrjet social, bie të kriteri i agjendës informuese, është vlerësuar nga ju.

**Z. I. Rusmali:** Këtë e thoni për shkak të pyetjes apo për shkak se është hetuar nga ana e Komisionerit kur ka bërë hetimin administrativ dhe është marrë në shqyrtim edhe faqja zyrtare e *facebook*-ut e bashkisë?

**Z. Y. Merkaj:** Kjo është një pjesë e hetimit dhe shqyrtimit administrativ. Në disa raste është marrë edhe faqja e bashkisë apo e raportuesit, është rast pas rasti në vazhdimësi. Në rastin konkret është marrë deklarimi apo raportimi që ka bërë nëpunësi me pjesëmarrjen i hapur për publikun. Është parë tematika...

**Z. I. Rusmali:** I kemi këto në rrethin e provave, mund t'i shqyrtojmë?


**Z. Y. Merkaj:** Po ua kemi paraqitur dosjen gjithsecilit.

**Z. K. Bele:** Një pyetje për përfaqësuesin e Bashkisë Durrës: Besoj që Bashkia Durrës ka faqe interneti. Publikohen të gjitha këto në faqen e internetit? Po apo jo?

**Z. V. Manushi:** Jo.

**Z. K. Bele:** Ne me kaq po e mbyllim shqyrtimin në këtë fazë të hetimit administrativ. Duke qenë se kemi shumë çështje, do t'i kalojmë njëra mbas tjetër ato dhe do

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

vendosim në varësi të volumit, duke qenë se janë edhe disa çështje, do disponojmë edhe me datën e shpalljes. Pra, në një kohë të dytë do të caktojmë momentin e shpalljes së vendimit që mund të jetë po sot, nëse do të arrijmë, ose për arsye objektive, duke dashur të grupojmë natyrën e problemeve, do t'ju njoftojmë nëpërmjet administratës nëse do të kemi një vendimmarrje që do të kërkojë më shumë kohë, do të japim një datë që do të jetë pas disa ditësh për shkak se disa nga anëtarët e KAS-it nuk janë prezentë në Shqipëri. Kështu që do t'ju njoftojmë lidhur me momentin e shpalljes.

**Z. V. Manushi:** Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Faleminderit, edhe ju!

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina Lekaj*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

28.02.2023

Ora 13:09

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 06 dhe 09 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Arisa Toska, Sekretare e Përgjithshme, Bashkia Berat””.**

**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

**Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. K. Bici,  
Znj. A. Agolli

**Të tjerë:** KRIIK

**Z. E. Çefa:** Çelim seancën e shqyrtimit në themel të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 6 e cila është bashkuar gjithashtu me kërkesën numër 9 sepse i përkasin propozimit të Komisionerit për ndërmarjen e sanksionit administrativ ndaj të njëjtit person, ndaj zonjës Arisa Toska me detyrë Sekretare e Përgjithshme, Bashkia Berat. Relator i kësaj çështje sikurse 4 tha edhe dje jam caktuar unë, Elvis Çefa. Në seancë paraprake të zhvilluar në datën 27 shkurt KAS vendosi të kalojë në shqyrtim këto kërkesa ankimore dhe ti bashkojë ato me njëra tjetrën. Është prezent Sekretari i Përgjithshëm i cili përfaqëson edhe Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve në këtë procedim administrativ dhe administrata e KQZ-së. Nuk ka persona të interesuar nga Bashkia Berat apo përfaqësues ndaj personit ndaj të cilit propozohet sanksioni administrativ. Në këto kushte mendoj që nuk kemi pengesë të fillojmë menjëherë me relatimin dhe dëgjimin e përfaqësuesit të kërkuarit. Zoti Sekretar i Përgjithshëm, fjala është për ju!

**Zbardhi materialin audio**

**Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. Y. Merkaç:** Faleminderit! Për kërkesën ankimore numër 6, gjatë periudhës së monitorimit datë 20 janar dhe 23 janar 2023 Bashkia Berat ka raportuar në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së 2 veprimtari jasht afatit ligjor të parashikuar nga neni 92, pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe konkretisht aktiviteti i këshillit raporton në datën 23.01.2023 dhe data e zhvillimit të aktivitetit data 24.01.2023 si dhe aktiviteti i këshillimit raport i datës 23 dhe data e zhvillimit të aktivitetit është data 23. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve gjatë shqyrtimit administrativ ka vlerësuar se këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Berat ka shkelur detyrimin ligjor duke mos raportuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë në masën 10,000 lek për shkelje të dispozitave të nenit 92 pika 2 të Kodit Zgjedhor ndaj personit përgjegjës të raportimit që është Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Berat. Gjithashtu në lidhje me kërkesën ankimore numër 9 periudha e monitorimit ka qenë data 24 janar deri në 2 Shkurt 2023 ku Bashkia Berat ka raportuar në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së 5 veprimtari jasht afatit ligjor të parashikuar nga neni 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor dhe konkretisht aktiviteti inspektim kontrolli i raportuar në datën 25.01.2023 dhe data e zhvillimit të aktivitetit ka qenë data 25.01.2023. Aktiviteti i dytë është inspektim kontroll raportuar datë 25.01.2023, data e zhvillimit ka qenë data 26.01.2023. Aktiviteti i këshillimit raportuar datë 25 dhe zhvillim i aktivitetit ka qenë data 28.01.2023. Aktiviteti inspektim kontroll i raportuar në datën 25.01.2023 dhe data e zhvillimit ka qenë data 27.01.2023. Aktiviteti i fundit është këshillim raportuar datën 01.02.2023 dhe data e zhvillimit të aktivitetit ka qenë data 05.02.2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se këto 5 veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Berat ka shkelur detyrimin ligjor duke mos raportuar

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

brenda afatit të përcaktuar në ligj. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë në masën 10,000 lek për shkelje të dispozitave të nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe personi përgjegjës është Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Berat. Ju faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Po, faleminderit ju! Thjesht për sqarim, më shumë për formalitet dhe për ta bërë pasqyrimin në procesverbal. Në të gjitha rastet e konstatuara në shkelje të afatit ligjor në të dy kërkesat ankimore pra, janë gjithsej 7 raste, të gjitha janë edhe në përfundim të hetimit administrativ të zhvilluara nga Komisioneri, të gjitha janë të konsideruara të vlefshme për efekt të venies së gjobës. Pra, Komisioneri të 7 rastet i ka kualifikuar si raste potencialisht në shkelje të ligjit, apo jo?

**Z. Y. Merkaç:** Janë vlerësuar si aktivitete publike.


**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Nuk kam pyetje tjetër. Kolegët?

Të gjitha kanë deklaruar që do të ketë edhe pjesmarrje të medias edhe që është aktivitet i hapur për publikun. Dakord atëherë meqënëse nuk kemi edhe palët e tjera prezent në sallë besoj që si konkluzion, zoti Sekretar i Përgjithshëm?

**Z. Y. Merkaç:** I qëndroj kërkesës së Komisionerit për vendosjen e masës administrative në masën 10,000 lekë për kërkesën e parë numër 6 dhe kërkesën e dytë numër 9, të dyja nga 10,000 lekë gjobë për Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Berat. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Pra në bashkim të dy gjobat do të jenë 10,000 lekë?

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

*Z. Y. Merkaj:* Jo, 10.000 lekë njëra dhe 10.000 lekë tjetra.

*Z. E. Çefa:* 20.000 lekë i bie?

*Z. Y. Merkaj:* Po!

*Z. E. Çefa:* Faleminderit! Atëherë sikurse tha edhe kolegu pak më parë ne do ta ndërpresim këtu këtë seancë për të vijuar me shqyrtimin e kërkesave të tjera të Komisionerit dhe në fund do të caktojmë edhe mënyrën dhe momentin e shpalljes së vendimit për këto kërkesa të Komisionerit. Seanca deklarohet e mbyllur.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

28.02.2023  
Ora 13.15

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtim të kërkesës nr. 07 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit Martin Dodi, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Fier”.**

**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

**Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. K. Bici,  
Znj. A. Agolli

**Të tjerë:** **KRIIK**

**Z. I. Rusmali:** Mund të fillojmë me sencën tjetër. Mirë, çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj zotit Martin Dodi, Sekretar i Përgjithshëm i bashkisë Fier, për shkelje në raport me detyrimet që ka për raportimin e veprimtarive publike. Seanca zhvillohet në prezencë të Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të stafit të tij, ku në mungesë të palës tjetër, zotit Martin Dodi, i cili është njoftuar rregullisht por nuk ka informacion nëse ka dashur të vijë apo jo, mungesa tregon vullnetin për ta injoruar këtë seancë. Kërkesa paraprake procedurale nuk ka, atëhere zoti Sekretar i Përgjithshëm pozicioni i Komisionerit lidhur me këtë çështje cili është?

**Z. Y. Merkaj:** Gjatë periudhës së monitorimit datë 24 janar deri më 2 shkurt 2023 bashkia Fier ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

Zgjedhjeve, 7(shtatë) veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në neni 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Gjatë hetimit administrative Komisioneri ka vlerësuar se 5 (pesë) nga këto veprimtari nuk përbëjnë veprimtari publike dhe dy, aktiviteti 1 dhe 2, konkretisht: Aktivitetet “Takimi me kërkesë të komunitetit Topojë”, raportuar në datë 25.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.01.2023. Dhe aktiviteti dytë, Aktivitetet “Takimi me kërkesë të komunitetit Dermenas”, raportuar datë 25.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit ka qenë data 28.01.2023.

I ka vlerësuar si veprimtari publike, ku Bashkia Fier duhet të raportonte brenda afatit të përcaktuar në ligj. Në këto kushte Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se këto veprimtari publike janë raportuar jashtë afatit të parashikuar dhe i ka propozuar Komisionit të Ankimit dhe Sanksioneve marrjen e masave administrative gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për shkelje të dispozitave të nenit 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, për Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Fier, zotin Martin Dodi. Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Mirë, faleminderit! Në listën e veprimtarive e cila është më shumë sesa 2, ka raportime për veprimtari që edhe nga raportimi pretendohet që nuk janë publike. Janë veprimtari që bëhen pa pjesëmarrjen e publikut, dhe pa pjesëmarrjen e mediave, sikurse ka 2 veprimtari të tjera të cilat janë referuar nga vet pala si veprimtari publike për këto dy veprimtaritë e tjera (të paktën për këto). Pse ka hequr dorë Komisioneri nga kërkesa për sanksionim?

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri gjatë shqyrtimit administrative ka vlerësuar dhe ka dalë gjatë hetimit ka rezultuar që këto nuk janë veprimtari publike. Ky është version i Komisionerit që 5 të tjerat nuk janë veprimtari publike, ndërsa 2 të parat kanë qenë

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

me prezencë të publikut dhe konkretisht me komunitetin e fshatit Topojë dhe Dermenas.

**Z. I. Rusmali:** Nga materialet që lexoj unë këtu, besoj, mbase e kam gabim, rezulton që Komisioneri ka konsideruar që ka patur një interpretim të gabuar ligjor nga ana e Bashkisë Fier në raport me kohëzgjatjen e afatit. Bashkia Fier ka numëruar 5 ditët duke “ngrënë” një ditë dhe Komisioneri e ka konsideruar këtë një lapsus, një gabim të falshëm për të cilin nuk ka nevojë për të vendosur masa ndëshkimore. Është ky apo është ajo që the?

**Z. Y. Merkaj:** Nuk ka qënë vetëm kjo ka qënë edhe nisur nga tematika e veprimtarive të raportuara Komisioneri ka vlerësuar se këto nuk janë veprimtari publike.

**Z. I. Rusmali:** Tryeza e diskutimit me komunitetin e njësisë Qendër mbi problematikat e zonës është raportuar nga vetë bashkia si veprimtari e hapur për publikun. Pse keni dalë ju në konkluzionin që ajo nuk është e hapur për publikun, si pasojë jopublike? E njëjta gjë edhe për tryezën e diskutimit me komunitetin në njësinë Mbrostar, e njëjta situatë është. Pse keni dalë në konkluzionin që nuk ka qënë hapur për publikun, keni pasur një shkak për të dalë në këtë konkluzion? Në dy të parat, tryezat e diskutimeve.

**Z. Y. Merkaj:** Po ndoshta për afate është pushuar hetimi administrativ për këto të pesta.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Gjithsesi nga ana e KQZ-së që të jemi të qartë, kalkulimi i afatit 5 ditor, nga ana e KQZ-së bëhet gjithmonë duke mos konsideruar datën kur

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

ndodh ngjarja? Pra në datën e kalkulimit, kështu e bëni ju kalkulimin apo ju e quani datën e raportimit dhe e llogarisni 5 ditë bashkë me këtë, si është praktika juaj?

**Z. Y. Merkaj:** Ne kemi llogaritur datën që raportohet dhe nuk kemi llogaritur datën kur bëhet aktiviteti.

**Z. I. Rusmali:** Rezultati del gjithmonë njesoj apo jo?

Mirë unë nuk kam pyetje të tjera.

Mirë e mbyllim shqyrtimin administrative edhe për këtë çështje, ka ndonjë kërkesë përfundimtare Sekretari i Përgjithshëm?

**Z. Y. Merkaj:** Po kerkojmë si Komisioni Qendror të Zgjedhjeve vendosjen e masës së gjobës në masën 10 000 lekë për Sekretarin e Përgjithshëm.

**Z. I. Rusmali:** Për dy shkelje të evidentuara dhe të kërkuara.

**Z. Y. Merkaj:** Gjoba 10 000 lekë është si dy, si një, si shtatë 10 000 lekë është propozuar gjoba.

**Z. I. Rusmali:** Jo dakord, por e keni kërkuar për dy, konfirmoni për këto dy shkelje masa e sanksionit të jetë 10 000 lekë. Në përputhje me pikën 1, të nenit 171 të kodit? Dakord! Mirë faleminderit, mbyllim këtu shqyrtimin administrative të kësaj kërkesë dhe si dhe për të gjitha kërkesat e tjera KAS-i do tërhiqet për të bërë konsultën e tij dhe do të njoftojmë shpalljen, eventualisht për një orë, ose ditën e mërkurë ora 12.30. Ne do të bëjmë gjithë tentativën që ta japim përgjigjen për një orë nëqoftëse nuk do të arrijmë dot, shpallja e të gjitha vendimeve do të bëhet ditën e mërkurë ora 12.30.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**28.02.2023  
Ora 13:26**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 10 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Delina Hoxha, Sekretare e Përgjithshme, Bashkia Roskovec”.**

**PJESËMARRJA :**

**KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.**

**Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. K. Bici, Znj. A. Agolli  
Të tjerë: KRIIK**

**Z. K. Bele:** Atëhere, çelim seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës nr.10 për sanksionin administrativ ndaj zonjës Delina Hoxha Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Roskovec. Kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kaluar në seancë paraprake. Relator jam unë, duke qenë se nuk kemi kërkesa paraprake, nuk shohim të kemi prezent anëtarë apo përfaqësues të Bashkisë Roskovec. Vazhdojmë sipas procedurës me Sekretarin e Përgjithshëm shkurtimisht ku konsiston shkelja e pretenduar.

**Z. Y. Merkaj:** Gjatë periudhës së monitorimit gjatë periudhës 24 Janar - 2 Shkurt 2023 Bashkia Roskovec ka raportuar në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së tre veprimtari jashtë afatit ligjor të parashikuara në nenin 92 pika 2 të Kodit Zgjedhor. Pas shqyrtimit administrativ nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është vlerësuar duke u nisur edhe nga tematika e veprimtarive të raportuara ka vlerësuar se veprimtaria e parë që është aktivitet ndërgjegjësues dhe informues raportohet me

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

datë 26.01.2023 dhe është zhvilluar me datë 27.01.2023, është veprimtari me karakter publik dhe për këtë Bashkia Roskovec ka shkelur detyrimin duke mos raportuar brenda afatit të përcaktuar në ligj. Ndërsa dy aktivitete të tjera pavarësisht se Komisioneri nuk e ka arsyetuar aktiviteti mbledhja e këshillit bashkiak dhe tryezë diskutimi nuk janë konsideruar si veprimtari publike. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masave administrative me gjobë në masën 10 mijë lekë, për shkelje të dispozitave të nenit 92 pika 2 të Kodit Zgjedhor ndaj personit përgjegjës për raportimin Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Roskovec. Faleminderit.

**Z. K. Bele:** Pra, në qoftë se e kuptova drejtë zoti Ylli, aktiviteti për të cilin është kërkuar vendosja e sanksionit ka të bëjë vetëm kjo që lidhet me shërbimin pyjor, një aktivitet i përbashkët në kuadër të cilit janë mbjellë edhe disa pemë. Pra, është aktiviteti...

**Z. L. Braho:** Këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike nuk ka përjashtuar Komisioneri. (pa mikrofon)

**Z. K. Bele:** Siç e shpjegoi zoti Ylli vetëm një veprimtari bëhet fjalë apo e dëgjova unë gabim.

**Z. Y. Merhaj:** Vetëm e para është konsideruar si veprimtari publike vetëm ndërgjegjësues dhe informues.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. L. Braho:** Tek vendimi nr.53 i Komisionerit thotë në fund për këto arsye: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura krijojë bindjen se aktivitetet janë raportuar jashtë afatit ligjor pa asnjë shkak të justifikuar. Nisur nga tematika e veprimtarive të raportuara, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se këto veprimtari, përbëjnë veprimtari publike. Nuk ka përjashtuar asnjë nga këto.

**Z. Y. Merkaj:** Është lapsus tek arsyetimi.

**Z. I. Rusmali:** Po tek kërkesa si është?

**Z. K. Bele:** Pra, kjo është kërkesa që po lexon.

**Z. L. Braho:** Unë po lexoj vendimin e Komisionerit. Edhe tek kërkesa thotë: Aktivitetet janë raportuar jashtë afatit pa asnjë shkak, nisur nga këto tematika të veprimtarive të raportuara Komisioneri vlerëson se këto veprimtari, përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Roskovec ka shkelur detyrimin ligjor. Pra, tek të dyja edhe tek vendimi dhe tek kërkesa ka mbajtur qendrimin që të tre aktivitetet konsiderohen aktivitete publike. Thotë aktivitetet ndërgjegjësues informues, aktivitet mbledhje këshilli bashkiak dhe aktivitet tryezë diskutimi. Ndërkohë tek raportimet që ka bërë vetë Bashkia Roskovec për aktivitetin për 100 vjetorin e krijimit të shërbimit pyjor thotë që është i hapur për publikun. Tek aktiviteti diskutim dhe miratimi i projekteve dhe vendimeve mbledhje të përmuajshëm të këshillit bashkiak thotë përsëri është i hapur për publikun. Ndërkohë për këtë komisionin për titujt vendorë të nderit thotë që nuk është as i hapur për median as i hapur për publikun.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

**Z. K. Bele:** Më fal, këtu ka një diskutim mendoj unë, përpara se të dëgjojmë se çfarë do të thotë zoti Ylli. Duke qenë se jemi për herë të parë para këtij shqyrtimi mund të kemi situatën kur pavarësisht se çfarë është në propozim, qendrimi që mban mund të jetë i ndryshëm ose sqarues ose plotësues. Pra, pastaj ne do ta vlerësojmë dhe do ta diskutojmë me njëri tjetrin se cili nga ato qendrime do të jetë për ne.

**Z. Y. Merkaç:** Unë mendoj dhe në konsultim me Komisionerin mendoj që vlerësimi ka qenë vetëm për aktivitetin e parë ndërgjegjësues informues, për pyjoren jo për dy të tjerat.

**Z. K. Bele:** Vetëm për një sqarim se e diskutuam edhe në seancë paraprake këtë. Ky aktivitet i pjesëmarrjes në këtë 100 vjetorin e shërbimit pyjor, shkelja ka të bëjë me faktin që këta kanë marrë pjesë në aktivitet dhe nuk e kanë raportuar 5 ditë përpara apo në qoftë se unë e kujtojë saktë bëhet fjalë për një postim të ja dy pemëve në facebook. Pra, ku konsiston publiciteti në kuptim të ligjit? Sepse kemi një moment që nga email-i këtu të paktën nga sa kam unë këtu përpara janë mbjellë 40 fidane në rregull ky është aktiviteti dhe pjesmarrës për median jo, dhe i hapur për publikun po. Pra, ka qenë një drejtor që ka nxjerrë pemët në facebook, pra ky është aktiviteti? Po publikimi në facebook është bërë nga ky drejtori, nga bashkia, apo nga kryetari?

**Z. Y. Merkaç:** Është bërë nga bashkia megjithatë të dy aktivitetet edhe mbjellja e pemeve dhe postimi i pemëve dhe aktiviteti që është zhvilluar për 100 vjetorin e ndërmarrjes pyjore të Roskovecit janë vlerësuar si veprimtari publike. Lloji i

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e masës sanksion administrativ në masën 10 mijë lekë për Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Roskovec për aktivitetin ndërgjegjësesues informues për 100 vjetorin si veprimtari publike e cila është raportuar jashtë afatit të parashikuar në ligj.

**Z. K. Bele:** Duke mbajtur të njëjtin qëndrim për 1 orë KAS do të jap vendim për çështjet e diskutuara. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

28.02.2023

Ora 14:35

**RENDI I DITËS**

**Vendimmarrja e shqyrtimit të kërkesave nr.05, 06, 07, 08, 09 dhe 10 të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje sanksioni administrativ”.**

**KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

**Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. K. Bici,  
Znj. A. Agolli

**Të tjerë:** Z. V. Manushi, Përfaqësuesi i Bashkisë së Durrësit.

**Z. K. Bele:** Në përfundim KAS në lidhje me Kërkesën nr.05 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për Bashkinë Durrës vendosi përfundimisht:

- Rrëzimin e kërkesës, pasi aktivitetet e lidhura me këtë kërkesë, nuk janë aktivitete publike dhe si të tilla nuk ka detyrimin për deklaram.

Për kërkesën nr. 08, e cila është e bashkuar me të njetën kërkesë u vendos:

- Pranimi i kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke vendosur sanksionin, masën prej 10.000 lekësh.

- Kundër këtij vendimi, bëhet ankim në Gjykatën Administrative, brenda një afati 45-ditor.

Me kaq shqyrtimi për këtë çështje deklarohet i mbyllur! **Vendimi nr. 16**

**Z. K. Bele:** Për sa i takon kërkesës nr. 10 që lidhet me Bashkinë Roskovec, për sanksionet e propozuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, lidhur me këtë bashki, KAS vendosi:

- Pranimin e kërkesës si dhe vendosjen e sanksionit në masën prej 5.000 lekësh.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.02.2023*

- Kundër këtij vendimi bëhet ankim në Gjykatën Administrative brenda një afati 45-ditor.

**Vendimi nr. 19**

**Z. E. Çefa:** KAS-i i konsultuar në vend, vendosi:

- Pranimin e kërkesave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 06 dhe nr. 09.
- Vendosjen e sanksionit 20.000 lekë ndaj zonjës Arisa Toska me detyrë Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Berat.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- Ndaj këtij vendimi lejohet ankim brenda afatit 45-ditor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Seanca deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr. 17**

**Z. I. Rusmali:** Shpallim vendimin për kërkesën nr. 07. Në përfundim të shqyrtimit KAS-i mori vendim për:

- Pranimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për marrjen e masës administrative ndaj zotit Martin Dodi, Sekretar i Përgjithshëm në Bashkisë Fier.
- Vendosjen e sanksionit në masën 10.000 lekë, për shkelje të dispozitave të nenit 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- Kundër këtij vendimi gjithashtu mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, brenda afatit 45-ditor.
- Ky vendim shpallet sot më datë 28.02.2023

Seanca deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr. 18**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*